RREGULLORE

"MBI MARRËDHËNIET E BANKËS SË SHQIPËRISË ME BASHKËPUNËTORË TË JASHTËM"

(Miratuar me vendimin nr. 54, datë 28.07.2010, të Këshillit Mbikëqyrës)

KREU I
TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti dhe fusha e zbatimit

1. Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i kritereve dhe procedurave të cilat rregullojnë marrëdhëniet e Bankës së Shqipërisë me bashkëpunëtorë të jashtëm, në funksion të realizimit të nevojave dhe të objektivave strategjikë të saj.

2. Subjekte të kësaj rregulloreje janë të gjitha njësitë organizative të Bankës.

Neni 2
Qëllimi

Kjo rregullore ka për qëllim, realizimin dhe rritjen e bashkëpunimit me institucione apo specialistë të fushave të ndryshme, nëpërmjet ndërmarrjes së studimeve, punimeve, aktiviteteve apo projekteve të përbashkëta.

Neni 3
Baza ligjore

Kjo rregullore nxirret në bazë dhe në zbatim të:

a) Ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar;
b) Statutit të Bankës së Shqipërisë; dhe
c) Akteve të tjera nënligjore të Bankës së Shqipërisë.

Neni 4
Përkufizime

Në këtë rregullore, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

"Banka" – është Banka e Shqipërisë;

"Bashkëpunëtorë të jashtëm" - janë institucionet apo specialistët, të cilët vënë në shërbim të nevojave të Bankës, energjitë dhe kapacitetet e tyre intelektuale, duke mundësuar kryerjen e punimeve, studimeve, aktiviteteve apo projekteve të përbashkëta në funksion të realizimit të nevojave dhe të objektivave të saj strategjikë;

"Institucione" - janë bankat qendrore, universitetet, institutet akademike dhe shkencore, organizatat joqeveritare, qendrat kërkimore, si dhe subjekte të tjera të ngjashme me ta, të cilët bashkëpunojnë me Bankën e Shqipërisë;

"Specialist" - janë individët, të cilët zotërojnë njohuri në fusha dhe shkenca të caktuara me të cilët Banka lidh marrëdhënie bashkëpunimi;

"Bashkëpunim"- është marrëdhënia midis bashkëpunëtorëve të jashtëm dhe Bankës, për kryerjen e punimeve, studimeve, aktiviteteve apo projekteve të përbashkëta në kuadër të realizimit të nevojave dhe objektivave strategjikë të saj;

"Departamenti propozues" - është njësia organizative e Bankës, e cila në përputhje me veprimtarinë e saj ndërmerr nismën dhe ndjek bashkëpunimin me bashkëpunëtorët e jashtëm;

"Bashkautorësi" – do të ketë kuptimin e përcaktuar në nenin 4 të Ligjit "Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e lidhura me të".

KREU II
KRITERET DHE PROCEDURAT

Neni 5
Fusha e bashkëpunimit

Në përputhje me fondet e planifikuara në buxhetin e Bankës së Shqipërisë të vitit ushtrimor të miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës, si dhe me nevojat e tyre, departamentet e Bankës përcaktojnë drejtimet dhe fushat kryesore në të cilat vlerësojnë se duhet të shtrihen bashkëpunimet, si dhe afatet e mundshme të kryerjes së tyre.

Neni 6
Grupi i punës

1. Në çdo rast bashkëpunimi, me nismën e Departamentit propozues, Guvernatori urdhëron ngritjen e një grupi pune, i cili ngarkohet me përcaktimin e objektit/ qëllimit të bashkëpunimit si dhe përzgjedhjen e bashkëpunëtorit të jashtëm.

2. Grupi i punës përbëhet nga 5 anëtarë, nga të cilët 3 anëtarë

përzgjidhen nga departamenti propozues dhe 2 anëtarë nga njësitë e tjera organizative të Bankës. Grupi i punës kryesohet nga Drejtori i departamentit propozues.

Neni 7
Kriteret e përzgjedhjes

1. Përzgjedhja e bashkëpunëtorit të jashtëm nga grupi i punës, bazohet në kriteret e mëposhtme:

a) për institucionet:
i. emri i mirë i institucionit,
ii. lidhjet me botën akademike,
iii. eksperienca në fushën ku ushtrojnë veprimtarinë,
iiii. niveli i punimeve /publikimeve shkencore.

b) për specialistin:
i. niveli i formimit shkencor;
ii. punime shkencore të mëparshme, të cilat janë publikuar ose dorëzuar për publikim;
iii. niveli dhe statusi i bashkëpunimit të specialistit me institucionet akademike ku ai ka studiuar;
iiii. njohuritë specifike dhe eksperiencat në fushën përkatëse të bashkëpunimit.

2. Grupi i punës përgatit një raport vlerësues, i cili duhet të përmbajë:

a) objektin dhe qëllimin e bashkëpunimit;
b) bashkëpunëtorin e jashtëm të përzgjedhur;
c) masën dhe mënyrën e pagesës; si dhe
d) afatin e bashkëpunimit.

Neni 8
Miratimi i bashkëpunëtorëve të jashtëm dhe objektit të bashkëpunimit

1. Departamenti propozues, në rastin e bashkëpunimit me specialistë, mbështetur në raportin e përcaktuar në pikën 2 të nenit 7 të kësaj rregulloreje, i propozon Guvernatorit të miratojë me urdhër të veçantë bashkëpunëtorin e jashtëm dhe objektin e bashkëpunimit. Në çdo rast, urdhri përmban:

a) objektin e bashkëpunimit;
b) bashkëpunëtorin e jashtëm (specialist);
c) masën dhe mënyrën e pagesës; si dhe
d) afatin e bashkëpunimit.

2. Në rastin e bashkëpunimit me institucione, bashkëpunëtori dhe objekti i bashkëpunimit miratohet nga Këshilli Mbikëqyrës,

bazuar në propozimin e bërë nga Departamenti i cili ka ndërmarrë nismën e bashkëpunimit. Në vendimin e miratimit, Këshilli Mbikëqyrës përcakton dhe masën, mënyrën e pagesës si dhe afatin e bashkëpunimit.

Neni 9
Masa e pagesës

1. Masa e pagesës për çdo objekt bashkëpunimi me specialistë mund të jetë deri në kufirin e tri pagave bazë mujore të pozicionit të punës "nëndrejtor", sipas përcaktimeve të bëra në rregulloren "Për strukturën e pagave, bazuar në klasifikimin e vendeve përkatëse të punës në Bankën e Shqipërisë".

2. Në rastet kur grupi i punës, i ngritur sipas nenit 6 të kësaj rregulloreje, vlerëson se pagesa për objekte të veçanta bashkëpunimi, duhet të jetë më e lartë se kufiri i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, me propozim të departamentit që ka ndërmarrë nismën e bashkëpunimit, Këshilli Mbikëqyrës miraton një pagesë me vlerë më të lartë.

Neni 10
Punësimi i bashkëpunëtorit të jashtëm

1. Në rastet kur bashkëpunimi për realizimin e punimeve të ndryshme, mes Bankës dhe bashkëpunëtorëve të jashtëm, kërkon qëndrimin e një ose disa specialistëve pranë Bankës, departamenti propozues në bashkëpunim me Departamentin e Burimeve Njerëzore, mund të propozojnë sipas rastit tek Guvernatori, lidhjen e një kontrate punësimi të përkohshëm, midis Bankës dhe specialistit përkatës.

2. Niveli i pagës që do të akordohet në këtë rast, do të jetë deri në kufirin e pagës bazë për vendin e punës "Nëndrejtor", sipas përcaktimeve të bëra në rregulloren "Për strukturën e pagave bazuar në klasifikimin e vendeve përkatëse të punës në Bankën e Shqipërisë".

3. Niveli i pagës përkatëse, përcaktohet nga Guvernatori me propozim të Departamentit të Burimeve Njerëzore dhe Departamentit propozues. Propozimi bazohet në:

a) nivelin (titullin) akademik që specialisti mban;
b) pritshmëritë për natyrën, vështirësinë dhe kompleksitetin e punimit/studimit;
c) punimet shkencore të mëparshme të tij dhe revistat në të cilat janë publikuar ose dorëzuar për publikim;
d) nivelin dhe statusin e bashkëpunimit të specialistit me institucionet akademike ku ai ka studiuar.

Neni 11
Marrëveshja mes palëve

1. Si rregull, në çdo rast bashkëpunimi të miratuar, mes bashkëpunëtorit të jashtëm dhe drejtuesit të departamentit propozues, nënshkruhet një marrëveshje paraprake nga të dyja palët.

2. Përjashtimisht nga pika 1 e këtij neni, në rastet kur e çmon të nevojshme, marrëveshja nënshkruhet nga Guvernatori i Bankës së Shqipërisë.

Neni 12
Pagimi i shpenzimeve dhe i dietave

1. Kur gjykohet e arsyeshme nga Administratorët, në rastet kur në Bankën e Shqipërisë kërkohet prania e bashkëpunëtorit të jashtëm, Banka mbulon të gjitha shpenzimet e udhëtimit, si dhe dietat dhe shpenzimet e tjera që bashkëpunëtori do të duhet të kryejë gjatë kohës së qëndrimit në Shqipëri.

2. Mbulimi i shpenzimeve të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, do të bëhet bazuar në dispozitat e udhëzimit "Për kuotat dhe procedurat e kryerjes së shpenzimeve të nevojshme, të lindura nga marrëdhëniet e Bankës së Shqipërisë me persona të tretë".

Neni 13
E drejta e autorit

1. Si rregull për punimet e realizuara nga bashkëpunimi me bashkëpunëtorët e jashtëm, e drejta e autorit i njihet Bankës.

2. Përjashtimisht me përcaktimin e bërë në pikën 1 të këtij neni, e drejta e autorit mund t'i njihet edhe bashkëpunëtorit të jashtëm. Në këtë rast, bashkautorësia përcaktohet në marrëveshjen e parashikuar në nenin 11 të kësaj rregulloreje.

Neni 14
Procedura e informimit

1. Departamenti propozues informon periodikisht Guvernatorin në lidhje me ecurinë e bashkëpunimit.

2. Në përfundim të çdo bashkëpunimi, departamenti propozues harton një raport vlerësues mbi realizimin e bashkëpunimit.

KREU III
TË FUNDIT

Neni 15
Publikimi i punimeve

Publikimi i punimeve të realizuara nga bashkëpunimi me bashkëpunëtorët e jashtëm, do të bëhet bazuar në rregulloren "Për procedurat e botimeve në Bankën e Shqipërisë".

Neni 16
Shfuqizime

1. Rregullorja "Mbi marrëdhëniet e bashkëpunimit me specialistë të jashtëm për nevoja të Bankës së Shqipërisë", miratuar me vendimin nr. 54, datë 10.07.2002, të Këshillit Mbikëqyrës, shfuqizohet.

2. Të gjitha dispozitat e akteve nënligjore të Bankës që bien në kundërshtim me këtë rregullore shfuqizohen.

Neni 17
Të tjera

Ngarkohen të gjitha njësitë organizative të Bankës së Shqipërisë, për zbatimin e këtij vendimi.

Neni 18
Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuq menjëherë.

KRYETAR I KËSHILLIT MBIKËQYRËS

ARDIAN FULLANI